



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim

Mbledhja nr. 84

Prishtinë, më 23.04.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Besian Mustafa, Milazim Salijaj, Isak Shabani, Ekrem Mustafa, Salih Zyba, Jetmire Vrenezi dhe Samra Ilijazi.

Munguan: Albena Reshitaj dhe Ganimete Musliu.

Pjesëmarrës të tjerë: Shefki Kastrati (NDI), Fehmi Hyseni, drejtor,

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit nga dt. 2.4.2024,
3. Shqyrtimi i Projektligjit 08/L-242 për Performancën energjetike të ndërtesave,
4. Informata për tjetërsimin e pronës së UP tek Fakulteti Teknik,
5. Inicimi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Vlerësimin e ndikimit në mjedis,
6. Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të "Toukbahçes" në Prishtinë rreth tjetërsimit të disa burimeve ujore.
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga dt.2.4.2024

Komisioni, me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi procesverbalin nga dt. 2.4.2024.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08-L-242 për Performancën energjetike të ndërtesave

Kryetarja, tha se Raportin me amendamente për këtë projektligj Komisioni e ka proceduar te komisionet e përhershme me date 4.4.2024, ndërsa Komisionet e përhershme nuk e kanë shqyrtuar, afati për ta shqyrtuar ka kaluar prandaj do t'i procedohet Kuvendit.

Meqë nuk kishte vërejtje, ajo i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni vendosi që Raporti me rekomandime për Projektligjin nr. 08-L-242 për Performancën energjetike të ndërtesave, procedohet në seancë plenare për lexim të dytë

4. Informata për tjetërsimin e pronës së UP tek Fakulteti Teknik

Kryetarja, tha se në lidhje me këtë temë është diskutuar edhe më parë në komision dhe për më shumë ia dha fjalën deputetit Milazim Salijaj.

Milazim Salijaj, tha: pas vizitave dhe takimeve që kemi realizuar së bashku me deputetët Salih Zyba, Isak Shabani dhe Albena Reshitaj, në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, Drejtorinë për Kadastër pranë Komunës së Prishtinës, Arkivin Ndërkomunal të Prishtinës, Arkivin Shtetëror të Kosovës dhe Agjencinë e Regjistrimit Civil në Prishtinë, në lidhje me shqetësimet e ngritura në Komisionin për Mjedis rreth tjetërsimit të Pronës Publike - Pronës komunale në kompleksin e parcelave tek Fakulteti Teknik kemi konstatuar këto të gjetura:

“Të gjeturat në lidhje me shqetësimet e ngritura për tjetërsimin e pronës publike-pronës komunale në kompleksin e parcelave tek Fakulteti Teknik në Prishtinë, Parcela Kadastrale Nr. 2725 - 1, Zona Kadastrale Prishtinë me sipërfaqe prej: 68 ari e 41m².”

1. Sipas historiatit për Parcelën kadastrale Nr. 2725 -1, të pranuar nga ana e Drejtorisë për Kadastër pranë Komunës së Prishtinës, shohim se prona publike – komunale, Parcela kadastrale Nr. 2725 -1, Zona Kadastrale Prishtinë me sipërfaqe prej 68 ari e 41 m² është tjetërsuar me datë 19.02.2002, në bazë të kërkesës nr. 301, nga ana e znj. Azemine Sahiti nga Prishtina;
2. Tjetërsimi i Parcelës kadastrale Nr. 2725 -1 nga prona publike – komunale, në emër të znj. Azemine Sahiti, është bërë në bazë të Aktgjykimit P.br.596/97, datë 27.05.1998, i Gjykatës Komunale në Prishtinë;
3. Nga kopjet e shkresave të lëndës, së bashku me kopjen e Aktgjykimit P.br. 596/97, datë 27.05.1998, të pranuar nga ana e Drejtorisë për Kadastër të Komunës së Prishtinës, shohim se ka elemente të shumta që na bëjnë të dyshojmë në saktësisë dhe ekzistimin e këtij Aktgjykimi,
4. Pas tjetërsimit të pronës në bazë të Aktgjykimit P.br. 596/97, datë 27.05.1998, e njëjta është trashëguar në vitin 2003 dhe pastaj është shitur në vitin 2020 tek personat e tjerë;
5. Sipas historiatit të pranuar nga Drejtoria për Kadastër pranë Komunës së Prishtinës, tani Parcela kadastrale Nr. 2725 -1 me sipërfaqe prej 68 ari e 41 m², evidentohet në emër të tre bashkpronarëve;
6. Me rastin e vizitës dhe takimit në Rektoratin e UP-së me datë 23.11.2023 nga ana e Zv. Rektorës znj.Pranvera Breznica na është dhënë kopja e kërkesës drejtuar UP- ës, nga ana e bashkëpronarëve të Parcelës kadastrale Nr. 2725 -1, Shpejtim Shefqet Kuqi nga Suhareka, Betim Nazmi Selmanaj nga Gllogjani dhe Kujtim Nazmi Selmanaj nga Prishtina të cilët kërkojnë nga ana e UP- së, Rektori prof. Dr. Qerim Qerimi që në emër të Qirasë të paguajnë shumën prej 2.020.158.09 € dhe atë duke e llogaritur që nga viti 2010 dhe duke i cekur objektet që gjoja se ekzistojnë që nga viti 2010, si objektet e laboratorëve të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti Teknik, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, ndërsa Kontrata mbi shitblerjen është e vitit 2020 (Nr. LRP 12501/2020, nr. Ref. 2922/2020 datë 10.11.2020), ndërsa në kërkesë potencojnë objektet e lartëcekura që nga viti 2010 që kanë

ekzistuar në parcelën të cilën e kanë blerë në vitin 2020. Shtrohet pyetja si e patën guximin ta blejnë pronën “e Fakultetit” në vitin 2020 me objektet të cilat veq se i kanë cekur në kërkesën e tyre se kanë ekzistuar që nga viti 2010, e ndoshta këto objekte kanë ekzistuar edhe më herët, të cilat mundë të verifikohen në lejet ndërtimore;

7. Me rastin e vizitës dhe takimit në Arkivin Ndërkomunal të Prishtinës dhe Arkivin Shtetëror të Kosovës me datë 02.02.2024, na është thënë nga ana e zyrtarëve përgjegjës të Arkivit se nuk Ekziston kurrfar gjurme e as Origjinali të Aktgjykimit p.br. 596/97, dt.27.05.1998, i Gjykatës Komunale në Prishtinë, si dhe e njëjta gjë është konfirmuar edhe në komunikimin elektronik me datë 05.02.2024, citoj; Po JU informojmë që pas hulumtimit të bërë nga ana e Arkivit Ndërkomunal Prishtinë erdhëm në përfundim që Lënda Civile për Aktgjykimin P.br. 596/97 i Gjykatës Komunale në Prishtinë dt.27.5.1998. Kjo lëndë mungon!

8. Nga ky fakt lind pyetja dhe dyshimi i bazuar, se si u tjetërsua prona publike në bazë të një Aktgjykimi të cilit askund nuk po i gjinden gjurmët e ekzistimit të tij,

9. Në bazë të këtij Aktgjykimi prona është tjetërsuar dhe ka kaluar në emër të Azemine Sahiti nga Prishtina, për të cilën kemi kërkuar informacione në Agjencionin e Regjistrimit Civil pranë MPB – së, për të cilën na është thënë se nuk ekziston asnjë informacion për Azemine Sahitin, për të cilën sipas Aktvendimit të Trashëgimisë shkruan se është e lindur me 07.06.1918 në Kolovicë kurse ka vdekur me 09.03.2002 në Prishtinë si dhe bashkëshorti i saj Osman Sahiti ka vdekur me datë 18.05.1968 në Koliq, që nënkupton se e njëjta ka jetuar 84 vjet dhe në bazë të këtyre të dhënave mbi datën e lindjes së Azemine Sahitit, Agjencioni i Regjistrimit Civil ka thënë se ky person nuk ekziston!, ndërsa nga kopjet në shkresat e lëndës të pranuar nga Drejtoria e Kadastrit shihet se është bërë një shqyrtim i trashëgimisë T.nr.153/2003 ,dt.08.05.2003 qku në atë shqyrtim të trashëgimisë shkruan se Gjykata shpall Enver Krasniqin, nipi i trashëgimlanses në tërë pasurinë trashëgimore, që në rastin konkret është përshkruar vetëm Parcela kadastrale Nr. 2725 -1, Zona Kadastrale Prishtinë me sipërfaqe prej 68 ari e 41 m²;

10. Të gjeturat e paraqitura në këtë Raport si dhe Konfirmimi për mos ekzistimin e Aktgjykimit P.br.596/97 dt.27.05.1998, as në Gjykatën Themelore në Prishtinë, as në Arkivin Ndërkomunal - Prishtinë dhe as në Arkivin Shtetëror të Kosovës japin elemente të mjaftueshme për të dyshuar se tjetërsimi i pronës publike në rastin konkret u bë në mënyr të Kundërligjshme;

Pretendohet se raste të tilla dhe të ngjajshme të tjetërsimeve dhe keqpërdorimeve me pronat publike të shtetit të Kosovës të kenë ndodhur shumë deri më sot dhe ky rast ndoshta është një nga shumë raste që dyshohet të kenë ndodhur në shtetin tonë, andaj nga ky takim ju bëjmë thirrje institucioneve të shtetit- Hetuesisë dhe Prokurorisë që urgjentisht të merren me rastin e tjetërsimit të Pronës publike-Parcela kadastrale Nr. 2725 -1, Zona Kadastrale Prishtinë me sipërfaqe prej 68 ari e 41 m²; dhe që të gjithë ata që abuzuan dhe keqpërdorën me pronën publike të qytetarëve të Kosovës të vihen para organeve të drejtësisë.

Salih Zyba, shtroi pyetjen se çka duhet bërë më tutje me këtë raport dhe a duhet të dërgohet në Kryesinë e Kuvendit dhe ajo pastaj të vendosë.

Milazim Salijaj, tha se kemi biseduar edhe te sekretari dhe na kanë thënë se ju e kompletini si raport dhe të drejtë keni si komision ose si individë me bë kallxim penal me përcjellë lëndën ne prokurori. Tash kemi dy raporte edhe atë për pronën e ish RTP-së dhe se komisioni duhet të vendosë se çka të bëhet më tutje dhe si të adresohet.

Kryetarja, kemi dy mundësi me dërgua si raport në kryesi dhe me ja dërgua gjykatës lëndën.

Salih Zyba, shtoi se organet e ndjekjes janë kompetente, mirëpo pasi është bë punë në kuadër të komisionit adresa ku duhet shkuar është kryesia e Kuvendit. Mund të jetë propozim të bëhet debat parlamentar ose të iniciohet komision hetimor.

Isak Shabani, fillimisht tha se nuk ka marrë pjesë në vizitat për këtë lëndë për pronën e UP-së, por vetëm për atë të RTP-së. dhe se e përkrahi çdo formë të mundshme për adresimit të kësaj çështje. Pyeti deputetin Salijaj, për aktgjykimin a ka aktgjykim origjinal apo kopje.

Milazim Salijaj, tha se kopje ekziston në Drejtorinë e kadastrit të Prishtinës, ndërsa në arkiva nuk është gjet asnjë gjurmë as kopje e as origjinal

Isak Shabani, pyeti a ekzistojnë dokumente se si është bartë për trashëgiminë?

Milazim Salijaj, për trashëgiminë ekziston një kopje e njëjte dhe ju kemi drejtua Gjykatës Themelore në Prishtinë për të cilën nuk na kanë dhënë informacione.

Isak Shabani, mendoj si komision na del shumë punë me ngritë kallëzim penal, por informatat që i kemi ti drejtohem drejtë kryesisë dhe nëse e sheh ta arsyeshme ajo bashkë me zyrën ligjorë ta procedojnë ndërsa nëse e sheh për debat atëherë duhet tërë materiali të jetë në dispozicion.

Kryetarja, me dërgua si propozim për debat në kryesi e pas debatit me kërkua një komision hetimor.

Salih Zyba, është mira ta dërgojmë në kryesi dhe se me debat ndoshta e arrijmë masën e duhur të paraprakisht duhet ta votojmë si komision.

Besian Mustafa, tha se nuk është aspak problem debati parlamentar apo komisioni hetimor, por frika ime është se po përfundon vetëm me aq dhe ideja është se cila është rruga apo mënyra më e mirë me mri te qëllimi dhe se ajo është kryesorja.

Pastaj, komisioni ftoi drejtorin *Fehmi Hyseni*, për të marrë skjarimet e nevojshme se si mund ta procedoj më tutje këtë çështje.

Kryetarja, pasi e falënderoi drejtorin *Fehmi Hyseni* për prezencën dhe tha se e kemi dy raporte për tjetërsim të pronave të cilat i ka përgatitë deputeti *Milazim Salijaj*, dhe se po mendojmë që dy raportet me ia përcjellë kryesisë. Pastaj pyeti se cilat janë mundësitë e komisionit për me adresu këtë çështje më mirë: me kërkua si debat parlamentar dhe me procedua tutje me komision hetimor, apo me procedu direkt te organet e drejtësisë.

Fehmi Hyseni, drejtor i drejtorisë për mbështetje të komisioneve parlamentare tha se këtë e kemi bisedua edhe më herët me deputetin *Salijaj* dhe propozimi ynë është që ai raport së bashku me një shkresë përcjellëse nga komisioni i juaj, të dërgohet njoftim në Prokurorinë themelore të Prishtinës kjo është rruga më e shpejtë dhe më e sigurt. Ndërsa në pyetjen e Kryetares, nëse duhet të dërgohet edhe në Kryesi. *Fehmi Hyseni*, tha se kjo nuk është lëndë për Kryesinë e Kuvendit.

Salih Zyba, tha: si kërkesë për debat parlamentar apo komision hetimor, cila është mundësia më e mirë për mu adresua kjo çështje dhe cila është procedura a duhet në emër të komisionit, në emër të deputeteve të nënshkruar apo si për me dërgua në kryesi?

Fehmi Hyseni, debatin parlamentar nuk iu ndal askush, mund të dërgohet në emër të 6 deputeteve. Ndërsa po që se ju e kishit nisë si mbikëqyrje të zbatimit të ligjit përkatës dhe në seancë e kishit dërgua si raport me rekomandime të mbikëqyrjes atëherë Kryesia e kishte rendit si pikë të rendit të ditës në seancë.

Kryetarja, në fund tha se do ta diskutoj së pari me Kryetarin e kuvendit dhe pastaj do të vendosim si komision se çfarë do të bëjmë më tutje me këto dy raporte.

5. Inicimi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Vlerësimin e ndikimit në mjedis,

Kryetarja, njoftoi se Ministria e Mjedisit ka kërkuar nga ne për me plotësua Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, sepse nuk i kanë përfshi aty edhe panelet solare dhe se ato janë të rëndësishme. Kam kërkua që Ministria me bë këtë ndryshim, ndërsa ata kanë kërkuar që Kuvendi me plotësua për shkak se është procedura me e shpejt nëse e merr iniciativë Kuvendi.

Salih Zyba pyeti pse ata nuk i kanë parapa me kohë në ligj këto ndryshime.

Kryetarja, tha se nismën do ta bëjmë jo si komision por si deputetë sipas rregullores dhe ju ftoj kush dëshiron të nënshkruani listën e inicimit për ndryshim plotësim të këtij ligji.

6. Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të “Toukbahçes” në Prishtinë rreth tjetërsimit të disa burimeve ujore.

Kryetarja, tha se kryetari i Bashkësisë lokale Sofali të Komunës së Prishtinës z. Enver Redenica e ka dërguar një emali/kërkesë në komision rreth tjetërsimit të disa burimeve ujore dhe të cilën e keni marr të gjithë. Ai këtë kërkesë ia ka drejtuar së pari Drejtorisë së Inspektionit dhe Parqeve të Komunës së Prishtinës lidhur me katër burimet ujore që ai supozon se ekzistojnë në Toukbahqe të cilat janë përvetësuar nga dikush, por deri me tani ai nuk ka marr përgjigje. Prandaj ai kërkon që komisioni të interesohet për këtë dhe ne duhet ti drejtohem me një kërkesë komunës së Prishtinës për të marrë informata për këtë çështje..

Salih Zyba, tha se përveç komunës së Prishtinës duhet ti drejtohem edhe MMPHI-së sepse ajo është përgjegjëse për burimet ujore, ndoshta edhe “K.R.U. Prishtina.”

Kryetarja, në fund tha se tha se do ta adresojmë këtë kërkesë në emër të komisionit, do të kërkojmë informatë të detajuar për këtë shkresë, nga tri institucionet përkatëse: MMPHI-së, Komunës së Prishtinës dhe K.R.U. Prishtina.

7. Të ndryshme

Isak Shabani, si kryesues i Grupit punues për Projektligjin për administrimin e banesave dhe lagjeve të banimit në bashkëpronësi, e ngriti një shqetësim për mos realizimin e vizitës së paraparë në Shqipëri, edhe pse janë bërë konsultimet dhe është përgatitë agjenda dhe në fund ka dështu. Neve na vjen keq për institucionet e Shqipërisë që kanë shpreh gatishmërinë për me na pritë dhe ne nuk kemi qenë në gjendje me shkua. Ndërsa pyeti a me vazhdua punën grupit punues pa vizitë apo me përsëritë vizitën. *Milazim Salijaj*, si anëtar i këtij grupi u pajtua me deputetin Shabani për vazhdimin e grupit punues.

Kryetarja, tha se problemi ka qenë agjenda e vizitës, sepse pa agjendë nuk kemi mund me bë kërkesën në Kryesi, pastaj pasi është bë agjenda problemi ka qenë se nuk është mbledhë Kryesia qe një kohë. Mirëpo ne mundemi me bo një kërkesë të re dhe se së pari duhet biseduar për agjendën dhe pastaj të bëhet kërkesa e re dhe se komisioni nuk duhet të diskutojë më për këtë, ndërsa ju vazhdoni punën si grup punues.

Ekrem Mustafa, në lidhje me zhurmën e lokaleve gjatë natës janë pengesë për qytetarët , një rast i veçantë në Mitrovicë të Veriut në Lagjen e Boshnjakëve është një kërkesë e banorëve se gjatë natës lokalet bëjnë zhurmë. Pyeti se kujt mundemi me ju drejtu.

Kryetarja tha se komuna e ka këtë përgjegjësi për me kontrollu nivelin e zhurmës në lokale dhe ata duhet ta adresojnë më mirë këtë problem.

Salih Zyba njoftoi për punën e grupit punues për Projektligjin për faturat e kulturave bujqësorë dhe fletmagazinat.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Fitore Pacolli-Dalipi,

Kryetare e Komisionit